

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**S VISION SH.P.K.**

Sot, më datë 11/01/ 2025

**XHULIO KODRA**, lindur ne Durres, i datëlindjes 09.03.1991, madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar, me numër identifikimi J10309078Q

ka përpiluar këtë Akt themelimi të Shoqërisë tregtare "**S VISION**" SH.P.K., me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare "**S VISION**" SH.P.K., themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kuifizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (këtu e më poshtë Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "**S VISION**" SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërsë është:

Aktivitet në fushën e pasurive të patundshme, duke përfshirë: Agjensi imobiliare, studime tregu për pasuritë e patundshme, akte ekspertize, projekte arkitektonike, rivleresim pronash, komisione dhe ndërmjetësim për të tretë, trajnim dhe konsulencë për shitjen e pasurive të patundshme, si dhe konsulencë në fushën e shitjes, blerjes, qiradhënieve dhe qiramarrjeve. Te kryeje blerjen, shitjen, administrimin dhe shkembimin e pasurive te paluajtshme. Aktivitete për restaurimin e pasurive dhe ndërmjetësim me agjensi turistike dhe kompani sigurimi.

Transport brenda dhe jashte vendit per vete, per te trete e me qira.

Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj.

#### NENI 4

##### Selia e Shoqërisë

Shoqeria ka seline ligjore:

Durres, Lagja 4, Rruga Egnatia, Zona Kadastrale 8514, Godine me nr. Pasurie 4/51

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte tij.

#### NENI 5

##### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë eshte 100.000 Leke (njeqindmije)lekë dhe përbëhet nga 1 (nje) kuote.

Z.XHULIO KODRA është zotërues e 1 kuote, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 100.000 leke.

#### NENI 6

##### Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

#### NENI 7

##### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – Organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjecar, me te drejte riemerimi..

Administratori i Shoqërisë do të jetë Z. XHULIO KODRA.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënje me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejtë në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

**NENI 8**

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesemarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijoje çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

**NENI 9**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

**NENI 10**

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 11**

**Legjislacioni i aplikuar**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqerise. Cdo gjë që nuk ështe parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

**ORTAKU THEMELUES**

**XHULIO KODRA**

*XHULIO KODRA* 